

5 qershor 2014, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Ekspozitë e fotografive “Prizreni po lulëzon”

EC Ma Ndryshe sot ka organizuar ekspozitë të fotografive në Sheshin Shatërvan në Prizren. Ekspozita “Prizreni po lulëzon” u organizua në kuadër të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës...” financuar nga Olof Palme International Center (OPIC), e cila përkrahet nga Qeveria e Suedisë. Ekspozita përmbante fotografi të realizuara nga stafi i organizatës dhe qytetarët e Prizrenit, të cilat tregojnë nivelin e kaosit, degradimit, papastërtisë dhe ngulfatjes në të cilën gjenden shumë lagje të Prizrenit. Këto fotografi edhe një herë dëshmuar cilësinë e jetesës së qytetarëve të Prizrenit, të cilët përballen me mjedis të ndotur, infrastrukturë të pamjaftueshme, zaptim të hapësirës publike, rrezikim të sigurisë publike.

Në hapjen e ekspozitës “Prizreni po lulëzon” u tha se “Veprimi qytetar nuk ka qenë asnjë herë më i nevojshëm se sot. Lulëzimi për të cilin flasin zyrtarët e komunës na bën të dyshojmë në aftësinë e tyre për t’i parë gjërat në mënyrë të drejtë. Ne, si kurrë më parë kemi nevojë për organizim qytetar që do ta demaskojë retorikën “lulëzuese” të zyrtarëve të komunës. Në fund të fundit, ne jo patjetër kemi nevojë për lulëzim a shkëlqim. Ajo që na duhet është të sigurojmë rend dhe rregull në qytetin tonë. Ta kthejmë Prizrenin e vjetër, i cili ka qenë i pastër, i mbajtur mirë, i lirë për lëvizje, i bukur për ta shijuar. Thjesht një Prizren që ka nevojë të dalë nga ngulfatja. Ne kemi nevojë për organizim qytetar që do t’ia kthejë qytetin qytetarëve.”

Ekspozita “Prizreni po lulëzon” është një thirrje për veprim të përbashkët dhe njëkohësisht një kritikë ndaj institucioneve të shtetit për veprim dhe jo për retorikë “lulëzuese”. Fotografitë e ekspozitës, të realizuara në një numër të madh lagjesh të Prizrenit për të gjithë ne duhet të jenë thirrje për veprim. Duke i thirrur ndërgjegjes sonë ne duhet ta forcojmë përgjegjësinë tonë për të shpëtuar qytetin nga kaosi, degradimi, uzurpimi dhe ngulfatja.

“Qyteti gjithëpërfshirës...” është projekt tre-vjeçar i EC Ma Ndryshe, i cili synon të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t’i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit. Grupet e komunitetit me të cilat punohet në këtë projekt janë: gratë, pleqtë, të rinjtë, personat me nevoja të veçanta, banorët e lagjeve të varfra, kultura dhe mjedisi. Me secilin grup të komunitetit, gjatë vitit 2014 të projektit do të organizohen dy fokus grupe dhe një debat publik, ndërsa paralelisht do të zhvillohet procesi i avokimit dhe bashkëpunimit me komunën e Prizrenit dhe Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për të siguruar përfshirjen e kërkesave të qytetarëve në planifikimin urban të qytetit.

Ju faleminderit.

Me respekt,
Fjolla Gashi, koordinatorë projekti
OJQ EC Ma Ndryshe

Projekti "Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren" përkrahet financiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahet nga Qeveria e Suedisë

